



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 28/12/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Pompa Elektrike 31681200-5
- Valvula 31711400-7
- Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtim 44
- Materiale hidraulike 44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2024, për objektin: **“Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatesisht **3,588,264 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$\underline{8,970,660 \times 40\% = 3,588,264 \text{ Lekë.}}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore per vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht **1,794,132 (një milion e shtatëqind e nëtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjet e dy) Lekë.**

(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

8,970,660 x 20% = 1,794,132 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që garancia e mallrave do të jetë 1(një) vit nga momenti i marrjes në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe se marrin

përsipër furnizimin e mallit në destinacionin e kërkuar dhe brenda afatit të levrimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi. Nuk është kërkuar që OE të kenë detyrimisht një mjet transporti ose të lidhin kontrata qeraje për mjetet por mund ta zgjidhin në çfarëdo mënyre alternative për realizimin e kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit të të gjithë artikujve në ambientet e Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK me kostot e veta.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

1	Transformator Fuqie 250 kVA, 6/0.4 kV, cu/cu	Cope	1
2	Pompe centrifugale me gjithë elektromotor dhe lëshuesit automatik me "soft starter", Prurja e pompes, Q=110 l/sek, Lartësia(Bruto me gjithë humbje) H=12,5m FuqiaP=22 KW	Cope	2.00

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5ton	në pronësi ose me qera	Copë	1

2	Kamion me vinc	në pronësi ose me qera	Copë	1
---	----------------	------------------------	------	---

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- certifikata e kontrollit teknik të mjetit,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura.

(të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 8 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar volumeve të punimeve, orëve të punës dhe kohëzgjatjes së punimeve për të cilat nevojiten këto materiale objekt prokurimi. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiderueshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës dy mjetet të cilët do të furnizojnë sipas nevojave të AK mallin e kërkuar në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera.

Specifikime teknike:

- **Pompë centrifugale**

Tipi	Pompë uji centrifugale
Fuqia	$P \geq 22$ kW
Tensioni	380 V
H_{thithjes}	$H \geq 4$ m
$H_{\text{dërgimit}}$	$H=8-10$ m
Klasi i mbrojtjes	IP44
Temperatura max e ambientit	+40
Prurja	$Q= 110$ l/s

Pompa të jetë e re, Markim (CE) dhe të ketë garanci minimumi 1 vit.

Elektromotor dhe lëshuesit automatik me "Soft starter" (është një lloj pajisje kontrolli që bën të mundur fillimin e ngadaltë të motorrit dhe kufizon goditjen mekanike).

- **Fllanxhë**

Presioni	10 bar
Materiali	Gizë
Përmasat	160 mm

Fllanxha vendoset në skajet e tubit për të bërë lidhjen dhe përforcimit mes tubit dhe pajisjes. Fllanxhat shtrëngohen në fund të tubit me bulona shtrënguese.

- **Saracineska gize me fllanxha**

Presioni	10 bar
Materiali	Gizë
Masa	160 mm

Rezistente ndaj temperaturave -20°C - +40°C. Saraqineskat duhet të jenë të markuara ku të lexohen qartë prodhësi, dimensionimi nominal i saraqineskës, dimensionimi nominal i flanaxhës, presioni nominal, data e prodhimit dhe matrikulli i makinës prodhuese.

Saraqineska duhet të jetë me gjuhëz në formë pyke. Gjuhëza ka formën e një pllake fleksible e cila mundëson rrjedhjen apo bllokimin e ujit nëpër tubacione.

- **Reduksion**

Presioni	10 bar
Materiali	Çelik
Përmasat	200x160 mm

Rezistente ndaj materialeve korrozive, rezistencë ndaj deformimeve të tokës dhe rezistente nga presioni deri në 10 bar.

- **Valvula moskthimi gize me flanaxha,**

Presioni	10 bar
Materiali	Gizë
Përmasat	160 mm

Valvulat e moskthimit horizontale bëjnë të mundur rrjedhjen e ujit në një drejtim të vetëm. Ato përdoren për të mbrojtur pjesë të pajisjeve që mund të preken nga rrjedhja e kundërt si dhe për të parandaluar përmbytjet, rrjedhën sipas gravitetit apo lehtësimin e kushteve të vakumit.

- **Ti d=160x3 PN 10**

Përmasat	160 mm
Materiali	Çelik i galvanizuar
Presioni	10 bar

Ti zingato me kënd 90° me 3 dalje me d= 160 mm. Duhet të jetë e qëndrueshme ndaj agjentëve atmosferikë dhe korrozionit. Projektuar për të bërë ballë presionit 10 bar.

- **Guarnicion – Material gomë**

- **Tuba celiku $\varphi > 200$**

Tubi i galvanizuar është bërë prej çeliku të ngurtë dhe veshjes shtesë të zinkut për të shmangur ndryshkun dhe korrozionin. Dimensionimi është d=200 mm.

- **Brryl**

Përmasat	d= 200 mm
Materiali	Gizë
Presioni	10 bar

Brryl gize me kënd 90°. Përdoret për instalimet këndore të linjave. Brryli bën të mundur degezimin e rrjetit në kënd 90°. E prodhuar me standarte të larta, shumë e qëndrueshme ndaj agjenteve atmosferik dhe korrozionit. Projektuar për t'i bërë ballë presionit deri në 10 Bar.

- **Tub HDPE Dn 160 mm, Pn 10**

Diametri	160 mm
Presioni	10 bar
Materiali	HDPE (Polietilen me densitet të lartë)
Gjatësia	6 ml
Standarti	GB/T13663-2000,ISO 4427-1:2007
Trashësia	2.3-57.2mm
Rezistente ndaj temperaturës	-25 °C – 55 °C

Jetëgjatësi të lartë. Duhet të jetë rezistente korrozionit, rezistencë kimike, fortësi fizike, rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve UV. Materiali duhet të jetë fleksibël dhe rezistent ndaj vibrimeve. Pamja e jashtme të jetë e lëmuar dhe padëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit, ngjyrë e zezë dhe vija blu. Duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj grryerjes.

Tubat HDPE duhet të vërtetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike.

Tubat duhet të jenë konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent.

- **Ti d=160x3 PN 10**

Diametri	160 mm me 3 dalje femër
Materiali	Polipropilen
Presioni	10 bar

Trupi i rakorderive të jetë material Polietilen me rezistence mekanike të lartë. Të suportojnë presionin deri 10 bar, dhe për këtë të jenë të testuara sipas standarteve EN 12201 (ose ekuivalente të tyre). Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK.

Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet të jetë homogjene dhe nuk duhet të jetë poroze.

- **Brryl d=160 PN 10**

Diametri	160 mm me 3 dalje femër
Materiali	Polipropilen
Presioni	10 bar

Trupi i rakorderive të jetë material Polietilen me rezistence mekanike të lartë. Të suportojnë presionin deri 10 bar, dhe për këtë të jenë të testuara sipas standarteve EN 12201 (ose ekuivalente të tyre). Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK.

Sipërfaqja e brendshme e produkteve duhet të jetë homogjene dhe nuk duhet të jetë poroze.

- **Hekur betoni i periodik Ø deri 12 mm2**

Shufrat e çelikut duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Eurokodit 2 – “Projektimi i Strukturave prej Betoni”, EN 10080 ose me standardet më të fundit të aplikuara.

Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C, me rezistencë në rrjedhshmëri $f_{yk}=500 \text{ N/mm}^2$ dhe deformacion karakteristik $\geq 7.5\%$.

Zërat e Materialeve:

- Hekur betoni i periodik Ø 6 mm
- Hekur betoni i periodik Ø 8 mm
- Hekur betoni i periodik Ø 10 mm
- Hekur betoni i periodik Ø 12 mm

- **Çimento 42.5 R**

Çimentoja e bardhë 42.5R duhet të jenë në përputhje me EN 206-1 dhe EN 197-1. Çimento Portland me CEM I, sipas EN 197-1.

- **Transformatori**

Lagështia relative 80 % në temperaturën e ambientit 40°C.

Temperatura e ambientit:

- Maksimum 40°C
- Mesatare vjetore 15°C
- Minimum -33°C
- Temperatura max mesatare e ambientit për 24h 35°C

Kushtet e erës:

Deri 40 m/sec, strukturat dhe pajisjet e këtij specifikimi duhet të jenë në gjendje të durojnë shtypje të vazhdueshme mekanike ekuivalente me erën 150 km/h (1000N/m2).

Kushtet sizmike:

Strukturat dhe pajisjet duhet të jenë në gjendje të durojnë lëkundje sizmike horizontale 2.5 ms-2. Për qëllime projektimi 80 % e vlerës së mësipërme duhet të konsiderohet për lëkundjet vertikale sizmike.

Sistemi i tokëzimit:

TM 6kV, me neuter të izoluar TU 0.4kV

Neuter të tokëzuar direkt.

Niveli i izolimit dhe lidhjes së shkurtër niveli i izolimit.

AC - Tensioni që duron frekuencë industriale 60 sekonda.

LI - Tensioni impulsiv që duron 1.2/50 sec.

SI - Tensioni impulsiv që duron në kyçje 250/3500 sec.

Niveli i izolimit rrjeti 6kV

- Tensioni më i lartë i sistemit 7.2 kV rms
- AC 20 kV rms
- Li 60 kV rms
- Neutri i transformatorit AC Plotësisht i izoluar

Niveli i izolimit dhe hapësirat:

Pajisja duhet të jetë e përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm në një sistem tre fazë 50 Hz.

Hapësira e punës siguroar në instalimet e jashtme midis pajisjes së izoluar dhe pjesë më të afërt metalike nuk duhet të jetë më pak se hapësira e specifikuar dhe nëse nuk është e specifikuar duhet të aplikohet standarti IEC për hapësirat.

Distanca e shkarkimit në izolatorë dhe pjastra nuk duhet të jetë më e vogël se 25 mm/kV në sistemin me tension më të lartë për pajisjet e jashtme.

Niveli i lidhjes së shkurtër

Rrjeti 6 kV, niveli i lidhjes së shkurtër

- 25 kA rms, 1 sekondë
- 40 kA

- Transformatori i shpërndarjes do të jetë transformator i mbushur me vaj i tipit i mbyllur hermetikisht ONAN.

- Transformatori do të ketë vlerë nominale të tensionit 6/0.4 kV.
- Rregullator i tensionit i cili vendoset në anën TM, do të jetë +/- 5% me 2.5% në çdo shkallë.
- Grupi i lidhjes do të jetë Dyn 5.
- Daljet TM dhe TU të transformatorit do të jenë për kabllor. Temperatura maksimale e lejuar do jetë:
 - Vaji 60°C (pjesa e sipërme)
 - Pëstjellat 65 °C (shtresa më e nxehtë)
- Transformatori i fuqisë do të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të përmbushi kërkesat e mëposhtme:
 - Të ketë cilësinë për t'i rezistuar çdo tronditjeje gjatë transportit të instalimit.
 - Të sigurojë shpërndarje efikase të nxehtësisë.
 - Të jetë i papërshkueshëm nga uji dhe vaji i nxehtë.
 - Të ketë zhurma dhe dridhje deri në një nivel të lejueshëm.
- **Nukli i transformatorit**
 - Konstruksioni i qarkut magnetik duhet të jetë i tillë që të shmangë zhvillimin e shkarkimeve statike të lidhjes së shkurtër në konturin e brendshëm ose në strukturën fiksuese të tokëzuar dhe prodhimin e komponentes së fluksit pingul me fletën e çelikut të petëzuar.
 - Çdo fletë e petëzuar do të izolohet me material të qëndrueshëm në kushtet e punës.
 - Qarku magnetik do të tokëzohet nëpërmjet një lidhje testuese me konstruksionin metalik, e cila vendoset në një pozicion të favorshëm.
 - Nukli i transformatorit do të prodhohet prej çeliku të cilësisë së lartë me kristale të orientuara. Nukli duhet të jetë i përbërë nga fletë çeliku të petëzuara dhe çdo fletë e petëzuar do të jetë e izoluar me llak të përshtatshëm për të shmangur humbjet nga rrymat fuko.
 - Nukli do të mbështetet në bazament nëpërmjet fiksueseve të izoluar dhe do të tokëzohet nëpërmjet një lidhje të heqshme.
 - Nukli (fletët e llamarinës) do të jetë i mbrojtur ndaj gërryerjes duke u lyer me një shtresë llaku me trashësi e pakta 1mm.

○ **Peshtjellat**

- Transformtorët do të kene peshtjella bakri elektrolit me përcjellshmëri të lartë ose peshtjella alumini. Materiali i izolimit do të jetë e Klases A (IEC 76-2).
- Izolimi i peshtjellave dhe lidhjet do te jete i lire nga kompozimi i izolacionit per te zbutur tkurjen ose keputjen gjete shfrytezimit.
- Peshtjellat do të jenë prej bakri elektrolitik ose alumini. Në mënyrë që të arrihet qendrueshmeria ndaj lidhjeve te shkurtra nga ana e tensionit te ulet, peshtjella e tensionit te ulet do te ndertohe me shirita bakri ose alumini ne vend te percjellesave. Transformatori do të ketë izolim të Klases A ose izolim më të mirë.
- Peshtjellat mund të izolohe me letër izoluese ose llak në përputhje me standardet e Prodhuesit.
- Ndertimi i peshtjellave do të jetë i tillë që të arrihet një shpërndarje e njetrajteshme e tensioneve impulsiv dhe tensioneve te shkarkimeve, duke shmangur pikat e dobëta në izolim.

○ **Kazani**

- Kazani i transformatorit do të prodhohet prej materiali me trashësi dhe fortesi të tillë që të rezistojë pa u dëmtuar apo pa u mbinxehur në kushtet e punës ose gjatë lidhjes se shkurtër.
- Transformatori do të jetë pa zgjerues vaji. Për kazanin dhe pjese të tjera, preferohet të përdoren konstruksione të salduara. Sistemi ftohës i transformatorit do të jetë me fletë llamarine ne pjeset anesore te depozitës.
- Transformatori do të pajiset me rrota qe levizin ne të dyja drejtimet për instalimin në objekt.

○ **Rregullatori i tensionit**

Rregullatori i tensionit do të sigurohet nëpërmjet një çelësi dhe do të vendoset në një vend të përshtatshëm (mbi kapak) për tu manovruar lehtësisht. Rregullatori i tensionit do te pajiset me nje celes rregullues me doreze te jashtme rrotulluese qe siguron bllokimin e rregulluesit ne pozicionin e zgjedhur. Mekanizmi duhet të jete nga jashtë transformatorit per manovrimin e tij. Pozicionet e rregullatorit te tensionit duhen shënuar qartë dhe të mos fshihen me kalimin e kohes. Pozicionet që korrespondojnë me vleren e rregullimit te rregullatorit do të stampohen ose do të gdhenden në një pllakë metali treguese, e fiksuar ne kapakun e transformatorit. Çelësi i rregullatorit te tensionit, duhet të ketë një vendosje të përshtatshme e ndertuar që të shmangë mundësinë e vendosjes te rregullatorit në një pozicion të ndërmjetëm. Lidhja e rregullatorit te tensionit me kapakun e transformatorit duhet te jete e tille qe te eliminoje rrjedhjen e vajt gjate shfrytezimit te tij.

○ **Terminalet**

Terminalet e kabllave të transformatorit do të projektohen duke pasur parasysh llojin e lidhjeve të përshkruara më poshtë:

Në TM: kablllo alumini të izoluar

Në TU: kablllo alumini të izoluar

Daljet e peshtjellave nga brenda jashte transformatorit duhet te realizohen me anen e izolatoreve kalimtare prej porcelani ngjyre kafe. Izolatoret duhet te jene per perdorim ne ambient te jashtem.

○ **Instrumentat dhe aksesoret**

Transformoret duhet te pajisen se paku me instrumentat dhe aksesoret e meposhtem:

- Tregues i nivelit te vajt
- Ganxha për ngritje
- Tape në pjesën e sipërme për mbushje me vaj

- Rubinet per kullimi vaji në pjesën e poshme
- Bulona për tokëzim ne pozicion diagonal
- Targeta
- Çelës i rregullatorit te tensionit
- Kapaku i tapes mbushese me vaj
- Bazamenti metalik per montimin e kazanit dhe te rrotave
- Shkarkues ne forme briiri.
- Pllakata ne shqip ne anen e tensionit te ulet;
- Valvul sigurie ose ndonje zgjidhje tjeter teknike kunder shkaterrimit te kazanit;
- o **Vaji izolues**

Transformatori do të pajiset me sasinë e duhur të vajit izolues me përmbajte minerali të cilësisë së lartë. Vaji do të jetë në përputhje me Standardin IEC 296.

- o **Kablo bakrit TU**

1- Te pergjithshme

- a. Materiali eshte projektuar per te punuar ne rrjet ne kushte atmosferike te ndryshme pa u demtuar.
- b. Kablli duhet ti rezistojë rezatimit UV.
- c. Kablli duhet te punojne ne kushtet e ndryshimeve te ngarkeses dhe tensionit nga lidhja e shkurter apo ndonje tjeter demtim qe mund te ndodh dhe te siguroje vlerat nominale ne paisje.

Te gjitha materialet e perdorura per prodhimin e kabllit duhet te jene cilesia me e mire dhe i pershtatshem per pune ne kushtet e specifikuar me poshte.

Kabujt duhet te kene markim CE.

2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikime teknike.
- Te gjithë test raportet e fabrikes.
- Skicat dhe dimensione.

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001.

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit dhe monitorimit te investimeve**, me shkesën me nr. 3778/2 datë 10.10.2024 nga drejtori Ing. Boreta Murati e cial është në cilësinë e specialistit të fushës për këtë objekt, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **10/01/2025, ora 11:00**.

I. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”**.

II. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Boreta Murati

Shkelqim Xhaferi